

**VENDIM**  
**Nr.41, datë 13.07.2007**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E SAKTË TË VLERËS SË  
GJOBËS DHE TË DËMIT TË SHKAKTUAR ENTIT SHPËRNDARËS PËRKATËS, SIPAS  
LLOJIT TË SHKELJES, MADHËSISË SË FUQISË SË INSTALUAR NË OBJEKT DHE  
KOHËS SË VËRTETUAR ME SHKELJE**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 46/1, pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa “a”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2007, pasi shqyrtoi draftin e dërguar nga shoqëria KESH sh.a. për përcaktimin e saktë të vlerës së gjobës dhe të dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës, sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fillimit të procedurave për përcaktimin e saktë të vlerës së gjobës dhe të dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës, sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje.

2. Ngarkohet grupi i punës për shqyrtimin e procedurave për përcaktimin e saktë të vlerës së gjobës dhe të dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës, sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**